

Jeta e Beqarit (pjesa 2)

THEMELI I NJË SHOQËRIE TË SHËNDETSHME

Jemi në pjesën e dytë të serisë "Jeta e Beqarit." Folëm për rritjen shpirtërore javën e shkuar. Sot do të flasim për shoqërinë e shëndetshme, si të kesh një shoqëri të mirë, të veçantë. Të gjithë kemi nevojë për shoqëri. Sa më shumë shokë të kesh, aq më e mirë dhe më e lehtë do të jetë jeta. Kjo nuk është vetëm për beqarët; edhe të martuarit kanë nevojë për shoqëri. Shokët janë pjesë e jetës, pjesë kyçe e saj.

Ajo që kam qenë duke menduar këtë javë, që ka lidhje me serinë, është se beqarët shikojnë çiftet dhe thonë: "Ah, sikur të martohesha dhe të gjeja burrin/gruan e duhur." Nga ana tjetër, çiftet me fëmijë thonë: "Ah, të isha edhe një herë beqar."

Atëherë i bie që kënaqësia është një stacion imagjinar, që s'arrihet kurrë atje. Unë besoj se mesazhi që do të ndaj sot do të nxjerrë në pah rëndësinë e shoqërisë së vërtetë, të sinqertë dhe të ngushtë.

Le ta fillojmë sot duke thënë disa gjëra që i dimë për shoqërinë. Çfarë janë?

Ne e dimë që shoqëria është një nevojë universale. Qysh nga momenti që ti ke qenë i vogël, nuk doje të rrije vetëm; doje shoqëri. Kur u rrite, u bërë fëmijë dhe doje shoqëri, fillove të luaje me shokët/shoqet e lagjes, të kopshtit. Pastaj, kur u rrite dhe u bërë adoleshent; më duket sikur adoleshenca është vetëm shoqëri; s'ka gjë tjetër më të rëndësishme. Shumë prej nesh kanë bërë gjëra në adoleshencë që s'donin t'i bënin, por i kanë bërë për shkak të shokëve. Sepse për një adoleshent, shoqëria është gjithçka. Ti bën gjëra që të thonë shokët, gjëra që as i mendon të bësh kur je vetëm. "Çfarë do bësh sonte? A ikim nga pishinat, rrimë gjithë natën?" "Jo, jo, s'vij!" "Po hajde, mos u bëj çun shtëpie, je burrë apo jo?" Dhe ti shkon diku që vetë nuk ke dëshirë, por i shtyrë nga shoqëria, shkon. Pra, shokët/shoqet plotësojnë një nevojë që nga fëmijëria e deri sot.

Dhe kur rritesh, shoqëria përsëri është e rëndësishme. Por ne maskohemi pas punës, jemi të zënë, megjithatë uria për shoqëri është akoma e madhe brenda secilit prej nesh. Nëse dikush është vetëm, e shikon si mangësi. "Kam ngelur vetëm, s'kam një shok..."

E dimë që shoqëria e keqe të lëndon dhe të krijon dhimbje. Sa nga ju janë lënduar nga një shok/shoqe? Ngrini dorën, të gjithë gati, nuk jeni vetëm. Ngrini dorën nëse ai/ajo që ju ka lënduar është ulur afër jush. Shaka. Shoqëria të lëndon, madje edhe shoqëritë më të ngushta sjellin lëndime. Shoqëritë e këqija, patjetër që po.

Disa nga ju ndoshta jeni lënduar tani së fundmi nga një shoqëri e prishur, dhe kur ndodh kjo, filloni të mendoni: “Çfarë kam unë kështu?” Ndiheni sikur keni qenë të mashtruar, ndiheni vetëm, të braktisur, ndjeni frikë dhe zhgënjim. Kjo ju çon në hidhërim, dhe hidhërimi prish shoqëritë e tjera.

Shoqëria e mirë është një thesar për atë që e ka. Shoqëria e shëndetshme bëhet një vend i sigurt, me persona të ngushtë, njerëz që ti i do dhe të duan, me të cilët qesh dhe qan. U shërbeni njëri-tjetrit, i njeh dhe të njohin.

Po lexoja diçka për shoqërinë dhe romancën. Shoqëria romantike është momentale; është si ato pambuk sheqerat që bëhen të mëdha me atë shkopin. Duket e madhe, e fryrë, por mbarohet shpejt. Por shoqëria e sinqertë siguron afërsi dhe siguri.

Po të kujtoj ndonjë shembull për shoqërinë nga Bibla, shembulli i parë që më vjen në mend është shoqëria e Davidit me Xhonatanin në Dhjatën e Vjetër. Ishin shumë shokë të ngushtë dhe i besonin jetën njëri-tjetrit. Kur Xhonatani ra në luftë, David tha në varrimin e tij:

2 i Samuelit 1:26 *'Unë jam në ankth për ty, o vëllai im Jonatan; ti ishe shumë i dashur për mua, dashuria jote për mua ishte më e mrekullueshme se dashuria e grave.'*

A mund të jetë e mundur që një shoqëri e sinqertë të jetë aq e ngushtë dhe më mirë sesa seksi? A mund të ketë miqësi më të ngushta se martesat? Kështu po mendon Davidi. Ndihma, mbështetja, besimi, argëtimi, siguria, sinqeriteti dhe falja që siguron një shoqëri e sinqertë janë gjëra që nuk blihen dhe nuk gjenden kudo.

Gjëja e fundit që dimë për shoqërinë është se **Shoqëria nuk forcohet kollaj.**

Pse? Sepse kërkon kohë që të forcohet një shoqëri; duhet të tregosh nga jeta jote, të rrezikosh, të kesh pasion, të kalosh nëpër konflikte, ngritje, pajtime dhe falje. Nga ana tjetër, shokët shpesh ikin dhe lëvizin në drejtime të ndryshme, duke bërë që të të duhet të nisësh një shoqëri të re nga zero.

Nëse shoqëria do të ishte diçka e lehtë, nuk do harxhonim kohë duke folur për të. Përgjithësisht, njerëzit duan t'i mbajnë shoqëritë e cekëta pa u thelluar në to.

Le të shikojmë në Bibël se çfarë thotë ajo për shoqërinë, udhëzime për shoqërinë nga Fjala e Perëndisë: le të shikojmë dy gjëra, dy hapa për të marrë, dy gjëra për të menduar këtë javë.

1. Zhvillo një shoqëri të ngushtë me Perëndinë.

Kush nga ju mund të më thotë që kjo është gjëja e parë që mendon për shoqërinë? Kur ti dëgjon fjalën "shok," ku të shkon mendja në fillim fare? Ke një person në mendje, besoj. Një shok të shkollës, ose të punës, nga lagjja. Dhe nuk e mendojmë Perëndinë si një shok. Për shumë prej nesh, Perëndia mund të jetë atje, mund të jetë i largët; është dikush që s'është i përfshirë. Ai përfshihet në jetën tënde vetëm kur ti e thërret, kur ti lutesh. Për disa, e lidhin Zotin me kishën. Kur vij në kishë, e ndjej Perëndinë; kur iki prej saj, nuk e marr më vete Zotin se më prish punë. Nuk e shikojmë Perëndinë si një shok të mundshëm, si shokun më të afërt. Shumë nga ne e pranojmë që Perëndia është i madh, është i fortë, di çdo gjë, është sovran. Por Ai s'është shoku ynë.

Dhe si rezultat, kemi krijuar disa ide për Perëndinë që nuk janë sipas Biblës, ide të tipit: "Perëndisë s'i afroresh dot; Ai nuk është i interesuar për mua, le të jetë Ai i zënë me gjëra të mëdha, ndërsa unë jam i vogël." Ne krijojmë në kokën tonë një model të Perëndisë.

E vërteta që thotë Bibla nga fillimi deri në fund, dhe është diçka që ju vetë e keni ndjerë në shpirtin tuaj pasi e keni pranuar Krishtin dhe Ai ka pushtuar, ka sunduar jetën tuaj, është se Perëndia ka kohë për ty. Ai ka dëshirë për të pasur një miqësi të ngushtë me ty; Ai do të jetë shoku yt.

Romakëve 5:10-11 *'Në fakt, ndërsa ishim armiq, u pajtuam me Perëndinë nëpërmjet vdekjes së Birit të tij, akoma më shumë tani, që jemi pajtuar, do të shpëtohem nëpërmjet jetës së tij. E jo vetëm kaq, por edhe mburremi në Perëndinë, nëpërmjet Zotit tonë Jezu Krisht, me anë të të cilit tani kemi marrë pajtimin.'*

Jemi pajtuar, jemi bërë shokë me Perëndinë; nuk jemi më të largët, nuk jemi më armiq, por miq. Kjo të mahnit: Perëndia, krijuesi i universit, që di çdo gjë që ka lidhje me ty, të njeh me emër, i njeh dobësitë e tua, përsëri do që të jetë shoku yt. Kjo është një e vërtetë e madhe.

Sa prej jush e kanë pranuar këtë të vërtetë si të vërtetë personale? Ti je shok me Perëndinë. Kur ka qenë hera e fundit që ke menduar për këtë, që ti je shok me Perëndinë? Nëse do të të pyeste dikush se kë ke shok të famshëm, të rëndësishëm, kë do të përmendësh të parin?

Imagjinoje veten në gjunjë para Perëndisë duke folur me të: "Zot, si do të ishte jeta ime nëse unë të lejoj ty ta pushtosh jetën time, të kontrollosh çdo gjë, dhe unë të besoj që ti je shoku im? A do ta ndryshonte kjo gjë jetën time? A do t'i ndryshonte fjalët që unë them, vendet ku shkoj, nëse unë do të besoja që Ti je shoku yt që është me ty gjithmonë?"

Nëse ti nuk je besimtar, por ke ardhur për herë të parë sot, ndoshta po mendon si është kjo kishë. Kur dëgjon këto gjëra, mund të thuash: “Çfarë është kjo kështu? Perëndia që ka krijuar botën, që është atje larg, që nuk përfshihet fare me çfarë ndodh në botë, do që të jetë shoku im? Kjo është e çuditshme.” Por Ai do që të vijë në jetën tënde, të bëhet shoku yt, nëse ti e hap zemrën Atij.

1 e Korintasve 1:9 *'Besnik është Perëndia, nga i cili jeni thirrur në bashkësinë (miqësinë) e Birit të tij Jezu Krishtit, Zotit tonë.'*

Fjalët e nënvizuara: Jemi thirrur. Ai të thërret ty sot; nëse nuk e njeh Atë, Ai të thërret që ti ta njohësh Atë.

Kur unë shikoj jetën time, koha më e bukur, ringjallja, ka ardhur për shkak të miqësisë time me Perëndinë dhe me shokët e mi. Kur ti thellohesh në miqësinë tënde me Perëndinë, ti vlerëson të tjerët më shumë; nuk i shikon më me sy dyshues. Thelbi, themeli i një shoqërie të shëndetshme është miqësia, shoqëria jote me Perëndinë.

Nëse të duket llafe të bukura pa vlerë, mos i dëgjo, fshiji nga memoria. Por Bibla është libri i librave; ajo nuk gënjen. Perëndia është shoku yt më i mirë; nëse ke merak dhe do që të kesh shoqëri të shëndetshme, fillo me Perëndinë, Ai është shoku yt.

2. Tregoju të tjerëve atë që ke marrë nga Perëndia.

Pra, fillon dhe forcon miqësinë tënde me Perëndinë. Ti e pranon që Ai është shoku yt më i mirë. Ti jeton jetën me këtë të vërtetë që Ai është me ty, çfarëdo që thuash dhe kudo që të shkosh. Pastaj ti u tregon të tjerëve. U jep atyre atë që ke marrë nga Perëndia. “Por çfarë kam marrë unë nga Perëndia? Çfarë do të thotë kjo?”

Gjoni 15:12-13 *'Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve. Askush s'ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij.'*

Jezusi po flet për miqtë, shokët. Ai jep jetën për ta. Nga kjo kuptohet dashuria: kur ti jep jetën për ta. Çfarë kuptimi kanë këto vargje? Ti nuk do të vrasësh veten; nuk ka këtë kuptim. Ti sakrifikon gjithçka për ta, dhe nëse kërkohet, jep jetën për ta. Tani po dalim nga diçka e vogël në diçka shumë të madhe.

Si e shpreh ti dashurinë ndaj të tjerëve? Duke sakrifikuar. Nëse do që të kesh shoqëri të shëndetshme, duhet të ketë sakrificë. Shoqëria kërkon sakrifica. Nëse nuk je gati të sakrifikosh për atë shok/shoqe, nuk është tamam shoku yt. Të gjithë duam të kemi shoqëri të ngushta, por sa po sakrifikon për ta?

Së pari, sakrificat e parë është që të mos jemi sipërfaqësorë. Të jesh i përgjithshëm është mënyra më e lehtë: “Si je? Mirë, po ti? Mirë, hajde, ditën e mirë.”

A do që t’i trembësh njerëzit kur thonë: “Si je?”? Ndalo dhe thuaju: “Faleminderit që pyete, pata një ditë të vështirë në punë, nga lekët s’jam mirë se duhen edhe ca ditë për të marrë rrogën...” Ai person nuk do të të pyesë më “Si je?”

Një nga mënyrat sesi thellohet miqësia është të flasësh për gjërat e tua personale, jo në përgjithësi. Trego ndonjë gabim që ke bërë. Trego ndonjë sfidë që po kalon, jo thjesht muhabet të përgjithshëm.

Nëse ndihesh i dashur nga Perëndia, tregohu i dashur me dikë. Nëse e ke kuptuar sa i veçantë je për Perëndinë, tregoji dikujt sesa i veçantë është ai person për ty. Nëse ke shpresë, jep shpresë.

Romakëve 1:12 *'Dhe kjo është që unë të ngushëllohem bashkë me ju me anë të besimit që e kemi të përbashkët, tuajin dhe timin.'*

Si përmbledhje: Ti thello miqësinë tënde me Perëndinë. Sa më afër të jesh me Perëndinë, aq më shumë do të japësh dhe do të ndihmosh dikë. Trego të tjerëve atë që ke marrë nga Perëndia.

E vërteta është, ne të krishterët duhet të kemi shoqëritë më të mira, më të ngushta, më të fuqishme dhe më të shëndetshme. Pse? Sepse këto lloj shoqërish kërkojnë sakrifikim dhe të krishterët e kuptojnë shumë mirë sakrificën, sepse e dinë sa shumë sakrifikoi Jezusi për miqësinë tonë me të. Ai sakrifikoi edhe jetën e vet. Ne e kuptojmë shumë mirë sakrificën, prandaj ne mund të bëhemi shokë me Perëndinë.

Nëse nuk je shok i Perëndisë, mund të bëhesh sot. Thjesht fto Jezusin në jetën tënde.

Madhësia e sakrificave që bëj do të përcaktojë cilësinë e shoqërisë që kam.

Ka shumë thellësi mendimi në këtë citim. Kjo është e vërtetë për miqësinë tënde me Perëndinë dhe me njerëzit.

Le të lutemi.